



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
MINISTRI

Nr. 5938 Prot.

Tiranë, më 3.11. 2020

**URDHËR**

Nr. 325, datë 3.11. 2020

**PËR**

**NGRITJEN E KOMITETIT TË MATURËS SHTETËRORE 2021**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.69/2012, datë 21.06.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimeve në shkollat e larta publike", i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Ngritjen e Komitetit të Maturës Shtetërore 2021 (KOMSH), me përbërjen si më poshtë:
  - a. Nina Guga, kryetar, Zëvendësministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë
  - b. Zamira Gjini, anëtar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
  - c. Selman Hodaj, anëtar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
  - d. Erzen Tola, anëtar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
  - e. Bledar Biçoku, anëtar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
  - f. Rezana Vrapit, anëtar, Qendra e Shërbimeve Arsimore
  - g. Gerti Janaqi, anëtar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
  - h. Arjan Xhelaj, anëtar, Rrjeti Akademik Shqiptar
  - i. Agim Aliaj, anëtar, Qendra e Shërbimeve Arsimore
  - j. Anila Ferizaj, anëtar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
  - k. Albana Çelaj, anëtar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
  - l. Tatjana Vuçani, anëtar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
  - m. Altea Tahiraj, anëtar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
  - n. Brunilda Dhamo, anëtar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Fier
  - o. Kristaq Grabocka, anëtar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Korçë
  - p. Bardhok Pulaj, anëtar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Lezhë

- q. Ana Dhamo anëtar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Durrës
- r. Ingrid Jushi, anëtar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- s. Erind Çela, anëtar, Qendra e Shërbimeve Arsimore
- t. Ermal Hasimja, anëtar, Gjimnazi “Ernest Koliqi”, Tiranë
- u. Rezarta Alla, anëtar, Gjimnazi “Ismail Qemali”, Tiranë
- v. Mira Kotobelli, anëtar, Gjimnazi “Sinan Tafaj”, Tiranë
- w. Erjeta Alhysa, anëtar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë
- x. Alqi Mustafai, anëtar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

2. Komiteti i Maturës Shtetërore 2021 ka për detyrë:

- a. Të miratojë kalendarin e veprimtarive në kuadër të Maturës Shtetërore 2021.
- b. Të shqyrtojë dhe të përgatisë dokumentacionin e Maturës Shtetërore 2021.
- c. Të thërrasë, kur e gjykon të arsyeshme, ekspertë të fushës.
- d. Të hartojë aktet nënligjore në ndihmë të procesit të Maturës Shtetërore 2021 dhe t’ia paraqesë për miratim ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- e. Të monitorojë në vazhdimësi zbatimin e akteve nënligjore të procesit të Maturës Shtetërore 2021.

3. Pranë Komitetit të Maturës Shtetërore 2021, funksionon Sekretariati Teknik, i përbërë nga:

- a. Ilda Sadikaj, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- b. Ergisa Bebja, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
- c. Kozeta Rokomanaj, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

4. Sekretariati Teknik ka këto detyra:

- a. Administron bazën ligjore të Maturës Shtetërore dhe dokumentacionin e mbledhjeve të KOMSH-it dhe i arkivon ato deri në një vit në arkivin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, (MASR).
- b. Njofton anëtarët e KOMSH-it dhe organizon infrastrukturën për zhvillimin e mbledhjeve të tij.
- c. Mban komunikim me institucionet e varësisë për ecurinë e procesit të Maturës Shtetërore 2021.
- d. Harton planin e veprimit për Maturën Shtetërore 2021 dhe raporton realizimin e tij në KOMSH.
- e. Monitoron ecurinë parapërgatitore të procesit të Maturës Shtetërore dhe raporton në KOMSH.
- f. Ndjek nënshkrimin e çdo dokumentacioni të mbledhjeve të KOMSH-it nga të gjithë anëtarët.
- g. Informon KOMSH-in për ecurinë e provimeve të Maturës Shtetërore, bazuar nga raportimet e ardhura nga përfaqësuesit e MASR, të cilët monitorojnë këtë proces.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti i Maturës Shtetërore 2021, Drejtoria e

Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit, Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurisë të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Rrjeti Akademik Shqiptar si dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

6. *Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.*

**MINISTËR**

**EVIS KUSHI**

